



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 108/3 Prot

Tiranë, më 10.3.2016

VENDIM

Nr. 04, datë 10.3.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit, *klinika "IKEDA Euromedica"*, sh.p.k.,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit Nr. 11, datë 28.01.2016 është kryer hetim administrativ pranë subjektit kontrollues *klinika "IKEDA Euromedica"*, sh.p.k., me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit klinika "IKEDA Euromedica" sh.p.k., i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Nga hetimi administrativ në vend, në datë 29.01.2016 e vazhdim, pranë kontrolluesit klinika "IKEDA Euromedica" sh.p.k., grupi i kontrollit konstatoi se:

I-Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale nëpërmjet një sistemi video-survejmimi CCTV. Në lidhje me detyrimin për informim (neni 18) rezultoi se, kontrolluesi nuk ka vendosur tabela informuese në hyrjet kryesore të ambjenteve, ku ai ushtron veprimtarinë e tij.

Në kuadër të garantimit të elementeve të sigurisë së përpunimit të të dhënave personale, kontrolluesi nuk ka hartuar një rregullore të veçantë për përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV.

Mungesa e tabelave informuese për kamerat në godinën e kontrolluesit, gjithashtu, mungesa e rregullave lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit të video-survejmimit në zbatim të nenit 27 të ligjit të sipërcituar, ndikojnë në sigurinë e të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit të video-survejmimit dhe në mos informimin e subjekteve të të dhënave mbi mundësinë e ushtrimit të të drejtave të tyre të sanksionuara në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Është i rëndësishëm, detyrues hartimi i një rregulloreje të mirëfilltë dhe specifike për përpunimin e të dhënave personale, për shkak të numrit të madh të të dhënave personale

që grumbullohen nga kontrolluesi, për më tepër të dhëna që lidhen me gjendjen shëndetësore të individëve, e si të tilla, tepër sensitive në kuptim të nenit 7 të ligjit.

Në lidhje me plotësimin e detyrimit për njoftim (neni 21 & 22), nga verifikimet e kryera pranë regjistrit elektronik të KDIMDP-së, u konstatua se ky kontrollues e ka përmbushur detyrimin për njoftim që prej vitit 2010 por, nuk ka përditësuar ndryshimin e gjëndjes së përpunimit të të dhënave.

2-Kontrolluesi nuk ka një rregullore të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, për përpunimin e tyre si dhe detyrimet që kanë palët në një marrëdhënie kontraktuale me të tretët. Grupi i kontrollit nga intervistimi që realizoi me përfaqësuesit e kontrolluesit, konkludoi se në ambiente dhe proceset e punës të kontrolluesit nuk ka rregullore dhe udhëzime specifike të shkruara "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*".

3-Kontrolluesi, nuk aplikon deklaratë konfidencialiteti, e cila është detyrim për çdo punëmarrës. Parë në frymën e ligjit (pika 2/dh neni 7 dhe neni 28), kontrolluesi duhet të aplikojë deklaratën e konfidencialitetit për të gjithë punonjësit, gjë e cila do të ishte një ndër masat kryesore e cila do të garantonte privatesinë e pacientëve/klientëve të tij. Kontrolluesi, duhet të marrë masa në mënyrë që, personat që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Çdo person që vepron nën autoritetin e kontrolluesit, nuk duhet t'i përpunojë të dhënat personale tek të cilat ka akses, pa autorizim.

4-Kontrolluesi, në marrëdhëniet kontraktuale me të tretët, nuk i kanë bashkangjitur kontratës bazë, aneks kontratën tip, për përpunimin e të dhënave personale nga palë të treta, sipas Udhëzimit Nr.19, datë 03.08.2012 të Komisionerit, "*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip, në rastet e këtij delegimi*", tagër më së shumti ky, në këtë rast i kompanive siguroese, se sa i klinikës "*IKEDA Euromedica*" sh.p.k. Pra, kontrolluesi edhe kur gjendet në kushtet e përpunuesit, mund të iniciojë marrëveshjen e konfidencialitetit me kontraktuesin.

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit, si dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-88 të Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar, në datë 01.03.2016 është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit, lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Në këtë seancë dëgjimore përfaqësuesit e kontrolluesit "*IKEDA Euromedica*" sh.p.k., paraqitën pretendimet e tyre:

I-"*Tabelat informuese nuk ishin prezente, pasi klinika është në periudhë punimesh*";
Ndërkohë kontrolluesi vazhdonte aktivitetin e tij normalisht.

2-“Sa i përket deklaratës së konfidencialitetit, juristja është me leje lindje dhe ju kemi dorëzuar kontratën e 2014. Sot para jush kemi sjellë një kontratë tip, ku theksohet dhe kjo gjë e sipërpërmendur”.

Bëj me dije se, neni 15 “Konfidencialiteti”, parashikuar në kontratën individuale-tip, të punëdhënësit- kontrolluesit “IKEDA Euromedica” sh.p.k., me punëmarrësin, është vetëm një paragraf, i cili më tepër është në funksion të interesave të ligjshme të kontrolluesit, por jo në funksion të mbrojtjes së të dhënave të pacientëve.

3-“Në rregulloren e klinikës është theksuar që punonjësit tanë nuk duhet të përhapin të dhënat për personat e rregjistruar në sistemin tonë si pacientë, sepse kjo përbën shkelje për ta. Kjo rregullore është hartuar në bazë të udhëzimeve nga ministria e shëndetësisë në bashkëpunim me zyrën e punës.”

Bëj me dije se, rregullorja për të cilën pretendon kontrolluesi “IKEDA Euromedica” sh.p.k., më së shumti, është rregullore mbi mbarëvajtjen aktivitetit shëndetësor të kontrolluesit, dhe jo në shërbim të mbrojtjes së të dhënave personale të pacientëve, ku të përfshihen të gjitha elementët e një rregulloreje: me përkufizime, rregulla, detyrime të palëve etj, sipas standartit të parashikuar në aktet e Komisionerit.

Rezultoni se, kontrolluesi është në shkelje të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar. Kontrolluesi ka patur gjithë mundësinë për tu njohur me ligjin dhe detyrimet që rrjedhin nga ky ligj, dhe aktet e tjera nënligjore.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 shkronja “b”, “ç” dhe “dh” e Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për informim, sipas përcaktimit në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me gjobë në vlerën 10 000 deri në 300 000 lekë.

dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.

Kontrolluesi, klinika “IKEDA Euromedica” sh.p.k., në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe, sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, ato lidhen me sigurinë e të dhënave personale, detyrimin për informim, si një e drejtë parësore në zbatim të ligjit dhe parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale.

Komisioneri gjithashtu, ka parasysh faktin që kontrolluesi ka qënë në bashkëpunim serioz me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 18, 27, 28, 30, 31, 39/1 shkronja “b”, dhe “dh”, 39/2, 40 dhe 41 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

VENDOSA :

1. Dënimin e kontrolluesit, klinika "IKEDA Euromedica" shpk, me gjobë, në vlerën **200 000 (dyqindmijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit, klinika "IKEDA Euromedica" sh.p.k., me gjobë, në vlerën **200 000 (dyqindmijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenet 27 dhe 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Kontrolluesi "IKEDA Euromedica" sh.p.k., të rikuperojë shkeljet e konstatuara nga grupi i kontrollit brenda një periudhe prej 30 ditësh.
4. Kontrolluesi, "IKEDA Euromedica" sh.p.k., në marrëdhënie me të tretët, edhe kur gjendet në kushtet e *përpunuesit*, domosdoshmërisht të realizojë dhe bashkëpunojë me kontraktuesin që e pajton për kryerjen e shërbimit "*chek-up*", mbi aneks kontratën tip të konfidencialitetit, sipas Udhëzimit Nr.19, datë 03.08.2012 të Komisionerit. për përpunimin e të dhënave personale nga palë të treta.
5. Gjoba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot në, 10.3 .2016

